



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:280774

Datë: 31.10.2023

Numri i dokumentit: 04856828

NE EMËR TË POPULLIT

P.nr.910/23

GJYKATA THEMELORE PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me procesmbajtëse Shpresa Kërnye në çështjen penale kundër të pandehurit P. G. nga Peja, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2075/2021 të datës 14.12.2021 për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 26.10.2023 në prezencë të prokurorit të shtetit Muharrem Bajraktari si dhe të pandehurit P. G. dhe të dëmtuarit M. K., të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 27.10.2023 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

P. G. , i lindur me, në Pejë, ku dhe jeton Lagja A.Q. nr..., i biri i M.dhe H., e gjinisë R., i martuar baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike punon si auto llamaristë, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër-lëshuar nga MPB R-Kosovës, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me dt.08.09.2021, rreth orës 19:30 minuta, ne Pejë në rr “ A. Q., seriozisht kanos personin tjetër dhe atë të dëmtuarin M. K., se do ti shkaktoj ndonjë te keqe me qellim te frikësimit ose shkaktimin te ankthit ne atë mënyrë qe i pandehuri shkon në oborrin e shtëpisë së të dëmtuarit duke e ofenduar me fjalë dhe duke i thënë “ kam me ta hek kryt” si dhe me shkelm rrëzon disa tulla dhe vazo të luleve, ashtu qe i dëmtuari dhe familjarët e tij duke e ndjerë veten te frikësuar e lajmërojnë Policinë për rastin.

- me çka ka kryer veprë penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074):

GJYKON

Të pandehurit P. G. i shqipton:

- DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 300 (treqind) euro, të cilin detyrohet ta paguaj në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast që i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.
- Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.
- Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga i dëmtuari.

ARSYETIM

- Historiku i çështjes dhe vendimi në lidhje me fajësinë;

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 14.12.2021 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2075/2021 kundër të pandehurve B.K. për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së dhe P. G. për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 26.10.2023, e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Muharrem Bajraktari si dhe të pandehurit P. G. dhe të dëmtuarit M. K..

Gjykata në kuptim të nenit 35 të KPPRK-së, me aktvendim ka veçuar procedurën ndaj të pandehurit Besim Kastrati ndërsa ka vazhduar procedurën me të pandehurin P. G. , në të cilën seancë i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit, në kuptim të nenit 242 par.2 dhe 6 të KPPRK-së gjykata vendosi që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri, pasi që është e qartë se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e pranueshme që e mbështesin aktakuzën dhe se aktakuza nuk përmban shkelje të qarta ligjore ose gabime faktike.

Ne lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit prokurori i shtetit deklaroi "Meqenëse i akuzuari e deklaroi fajësinë Konform kushteve ligjore të parapara me nenin 242 të KPPRK-së, nga Gjykata kërkoj që të njëjtin ta shpall fajtor, ta dënoj si pas ligjit si dhe ta obligoj në paaguarjn e shpenzimeve të procedurës penale. Ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese"

I dëmtuari M. K., deklaroi "Edhe pas këtij rasti ne kemi pasur prapë telashe, e kam lajmëru policinë sa herë që kemi pas telashe, kemi probleme me ta si fqinjë, kam pa ndërprerje ngacmime nga familja e tyre, gjatë gjithë kohës kam kërcënime prej tyre".

I pandehuri P. G. , deklaroi " Shprehi keqardhje që ka ndodhë ky rast, jomë kone i nervozuam me rastin që ka ndodhë, ka qenë afekt i atij momenti e kurrkujt nuk i vjen mirë me shku me ja sulmu nonën në oborr të vetë e me i thonë gjithçka, është e vërtetë se lëshojmë muzikë, janë sende që ndodhin, krejt ky rast është shkaku i një pllaci që e kanë ble këta në mënyrë të fshehtë, unë gjatë gjithë ditës jam në punë punoj, e nuk kam kontakt me ta, e këta janë gjatë gjithë ditës kah shtëpia dhe ofrohen te oborri, bile në Janar kojshija M., ka dal në rrugë me një hu unë isha me fëmijë në veturë dhe shkaku i fëmijëve dhe me i ikë më të keqes kam ikë nga aty, pra kemi as telashe vazhdimisht e këta e kanë thirr policinë gjithmonë për kurgjo hiq, nana nuk ka ardhur se është sëmurë sidomos prej këtij rasti".

- Vendimi lidhur me dënimin;

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe renduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehurit ligjvënësi ka paraparë mundësin e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj, e në këtë rast gjykata

ndaj të pandehurit vendosi qe të shqiptoj dënim me gjobë prej 300 (treqind) euro, të cilin detyrohet ta paguaj në afat prej tre (3) muajsh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, në rast qe i pandehuri nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin nuk kemi fare rrethana renduese, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata e gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar dhe keqardhjen e shfaqur nga i pandehuri me rastin e pranimit të fajësisë, ku duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 të KPRK-së gjykata vendosi qe ndaj të pandehurit të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dënimin me gjobë gjykata e shqiptoj duke u bazuar në faktin se për veprë penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë shqiptimin e dënimit me gjobë ose me burgim në mënyrë alternative, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 43 par.1 dhe 2 të KPRK-së vendosi qe të pandehurit t'i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, më bindjen se ky dënim, do të arrijnë në mënyrë të mjaftueshme të shpreh gjykimin shoqëror për veprën e kryer.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit P. G. është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPRK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal
P.nr.910/23, me datë 27.10.2023

Procesmbajtësja:
Shpresa Kërnje

Gjyqtari i vetëm gjykues:
Leon Përlaska

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.